

C.nr. 692/ 18

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me gjyqtaren Afijete Sada Gllgjani dhe procesmbajtësen Miranda Marku, në çështjen juridike të paditësve 1. Sh. B., 2. Sh. B., 3. R. H., 4. K. O., 5. S. R., 6. S. H., 7. E. H., 8. Z. M. që të gjithë nga Gjakova të cilët i përfaqëson i autorizuari i SBASHK-ut B. Sh., kundër të paditurës K. Gj.- D. e A., kontest pune- kompensim të pagave për përcjellje në pension dhe shpërblim jubilar, vlera kontestit 21 105,84 €, në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datë 27 dhjetor 2018 në prezencën e të autorizuarit të paditësve e në mungesë të paditurës, murr këtë;

A K T G J Y K I M

I. DETYROHET e paditura K. e Gj. – D. e A. që paditëses **Sh. B.** nga Gjakova të ia paguajë borxhin në emër të tri pagave përcjellëse në pensionim, sipas pagës mesatare për tre muajt e fundit nga 450.20€ shumën prej 1350.60€ dhe për shpërblim jubilar sipas pagës bazë për tre muajt e fundit para pensionimi, dhe atë për tri paga në shumën prej 405.00€ shumën prej 1 2150,00 €, gjithsejtë shumën prej 2571.60€ (dymijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një euro e gjashtëdhjetë cent) dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumë prej 40,00€ të gjitha në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura K. Gj. - D. A. që paditëses **Sh. B.** nga Gjakova të ia paguajë borxhin në emër të tri pagave përcjellëse në pensionim sipas pagës mesatare për tre muajt e fundit muajt nga 525.87€ shumën prej 1577.61€ dhe për shpërblim jubilar sipas pagës bazë për tre muajt e fundit për tri paga nga 442.00€ shumën prej 1326.00€ gjithsejtë shumën prej 2903.61€ (dymijë e nëntëqind e tre euro e gjashtëdhjetë e një cent) dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumë prej 40,00€ të gjitha në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

III. DETYROHET e paditura K. Gj. - D. A. që paditësit **R. H.** nga Gjakova të ia paguajë borxhin në emër të tri pagave përcjellëse në pensionim sipas pagës mesatare për tre muajt e fundit nga 472.19€ shumën prej 1416.57€ dhe për shpërblim jubilar sipas pagës bazë për tre muajt e fundit për tri paga nga 405.00€ shumën prej 1215.00€ gjithsejtë shumën prej 2631.57€ (dymijegjashtëqindetridhjetënjë euro e pesëdhjetë e shtatë cent) dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumë prej 40,00€ të gjitha në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

IV. DETYROHET e paditura K. Gj. - D. A. që paditësit **K. O.** nga Gjakova të ia paguajë borxhin në emër të tri pagave përcjellëse në pensionim sipas pagës mesatare për tre muajt e fundit nga 462,00€ shumën prej 1386,00€ dhe për shpërblim jubilar sipas pagës bazë për dy muaj nga 405.00€ shumën prej 810,00€ gjithsejtë shumën prej 2196,00€ (dymijënjëqindëntëdhjetë e gjashtë euro) dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumë prej 40,00€ të gjitha në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

V. DETYROHET e paditura K. Gj. - D. A. që paditëses **S. R.** nga Gjakova të ia paguajë borxhin në emër të tri pagave përcjellëse në pensionim sipas pagës mesatare për tre muajt e fundit nga 504.19€ shumën prej 1512.57€ dhe për shpërblim jubilar sipas pagës bazë për tre muajt e fundit

nga 442.00€ shumën prej 1326.00€ gjithsejtë shumën prej 2838.57€ (dymijetëqind e tridhjetë e tetë euro e pesëdhjetë e shtatë cent) dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumë prej 40,00€ të gjitha në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

VI. DETYROHET e paditura K. Gj. - D. A.që paditëses **S. H.** nga Gjakova të ia paguajë borxhin në emër të tri pagave përcjellëse në pensionim sipas pagës mesatare për tre muajt e fundit, për tri paga nga 448.59€ shumën prej 1465.77€ dhe për shpërblim jubilar sipas pagës bazë për tre muajt e fundit për tri paga nga 405.00€ shumën prej 1215.00€, gjithsejtë shumën prej 2680.77€ (dymijë e gjashtë qind e tetëdhjetë euro shtatëdhjetë e shtatë cent) dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumë prej 40,00€ të gjitha në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

VII. DETYROHET e paditura K. Gj. - D. A.që paditësit **E. H.** nga Gjakova të ia paguajë borxhin në emër të tri pagave përcjellëse në pensionim sipas pagës mesatare për tre muajt e fundit nga 475,62€ shumën prej 1426.86€ dhe për shpërblim jubilar sipas pagës bazë për tre muajt e fundit, për tri paga nga 405,00€ shumën prej 1215.00€ gjithsejtë shumën prej 2641,86€ (dymijë e gjashtëqind e katër dhjetë e një euro e tetëdhjetë e gjashtë cent) dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumë prej 40,00€ të gjitha në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

VIII. DETYROHET e paditura K. Gj. - D. A.që paditëses **Z. M.**nga Gjakova të ia paguajë borxhin në emër të tri pagave përcjellëse në pensionim sipas pagës mesatare për tre muajt e fundit, nga 475.62€ shumën prej 1426.86€ dhe për shpërblim jubilar sipas pagës bazë për tre muajt e fundit, për tri paga nga 405.00€ shumën prej 1215.00€ gjithsejtë shumën prej 2641.86€ (dymijë e gjashtë qind e katër dhjetë e një euro tetëdhjetë e gjashtë cent) dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumë prej 40,00€ të gjitha në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit me padi, parashtrës nëpërmjet të autorizuarit të tyre kanë parashtruar se kanë qenë në marrëdhënie të rregullt pune te e paditura dhe kanë punuar në cilësinë e mësimdhënësve, sekretarëve dhe punëtorëve teknik atë deri në kohën e pensionimit. Pas pensionimit, paditësve ju ka takuar e drejta në nga tri paga përcjellëse, në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit dhe e drejta në tri paga jubilarë. Bazën ligjore të padisë e mbështesin në Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar të datës 11 prill 2014 sipas së cilës me dispozitat e nenit 36.9 thuhet “ Punëtoret që dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar në vlerë siç vijon;

- 7.1 për 10 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë,
- 7.2 për 20 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të dy pagave bazë,
- 7.3 për 30 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave bazë,
- 7.4 punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilar,
- 7.5 Shpërblimet jubilar paguhen nga punëdhënësi në afatin prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve”.

Më tutje sipas dispozitave të nenit 36.10 “ Punëtorët që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit.”

Sa i përket përgjigjes në padi i autorizuari i paditësve e ka konsideruar si të pabazuar. Ndërkaq ka theksuar se paditësi K. O. ka marr një pagë shtesë me rastin e pensionimit atë e ka realizuar dhe ajo rrethanë nuk kontestohet ashtu që për paditësin K. pagat përcjellëse janë kërkuar në shumën prej 810,00€ ndërsa shpërblimi jubilar është kërkuar në shumën prej 1215.00€ për tri paga.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësve ka propozuar që kërkesë padia e precizuar të aprovohet si e bazuar. Kamatën ligjore nuk e kërkoi.

Shpenzimet procedurale u kërkuar vetëm sa i përket taksave për padi.

E paditura me përgjigje në padi ka parashtruar se sipas dispozitave ligjore të cilat kanë qenë në fuqi të drejtat dhe detyrimet e personelit të punësuar në Ministrinë e Arsimit janë të rregulluara me Ligjin e Punës nr.03/L-212 i cili nuk ka paraparë asnjë benificion apo privilegj për personat të cilëve ju ndërprehet marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore, me mbushjen e moshës së pensionimit.

Ish Ministri i MASHT-it Ramë Buja me kryetarin e SBASHK- ut Rrahman Jasharaj kanë nënshkruar Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar ku sipas nenit 2 zbatimi i Kontratës është për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private para universitare në mbarë territorin e Republikës së Kosovës të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut. Në nenin 36 rregullohet garantimi i pagave dhe sipas pikës 9 anëtarët e SBASHK-ut –punëtorët që dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar, por kontrata nuk është e zbatueshme dhe nuk mund të ketë efekt retroaktiv.

Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të nënshkruar me datë 18 prill 2017 në mes të Arsim Bajrami - Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Rrahman Jasharaj - Kryetar i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës përkundër nenit 46 të asaj Kontrate, nga ana e MASHT- it dhe SBASHK- ut nuk janë angazhuar për të i informuar dhe ndihmuar Komunitat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e asaj Kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit. U propozua që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pa bazuar.

Shqyrtimin kryesor të treguar me datën 27 dhjetor 2018 Gjykata e ka mbajtur në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt me propozimin e të autorizuarit të paditësve bazuar në nenin 423.4 të LPK.

Për të vendosur në këtë çështje juridike Gjykata bëri nxjerrjen e provave si ; vendimit ... datë ... , vërtetimit numër ... datë ... , deklaratës së llogarisë P.C. B. datë ... për Sh. B., vendimi ... / datë ... , vërtetimit numër. ... datë ... , deklarata e llogarisë P.C.B. ... për Sh. B., vendimit ... datë ... vërtetimit nr. ... datë ... , vërtetimit nr. ... datë ... , deklaratës së llogarisë P.C.B. datë ... për R. H., vendimit ... datë ... , vërtetimit nr. ... datë ... , librezës së punës në fotokopje nr. ... , numri i regjistrimit ... , llogaris bankare R. B. datë ... për K. O., vendimit ... datë ... , vërtetimin nr.prot. ... e datës ... , historiatit të llogariës së B. E. datë ... për S. R., vendimit ... datë ... , vërtetimit nr. ... datë ... , vërtetimit port nr. ... datë ... , vërtetimit nr. port ... datë ... , deklarata e llogarisë R. B. datë ... për S.

H., vendimit ... datë ..., vërtetimeve të datës ..., deklaratës së llogarisë e P.C.B. të datës ... për E. H., vendimit ... të datës ..., vërtetimit të datës ..., vërtetimit të datës ..., qarkullimit për llogari N. B. të datës ... dhe të datës ... për Z. M., ku pas vlerësimit veç e veç të këtyre provave dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke gjeti se kërkesë paditë e precizuara të paditësve janë të bazuara dhe si të tilla u aprovua.

K. Gj. - D. A., paditëses së parë Sh. B. e lindur me ... e punësuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SHFMU "Gj. F." B. i ndërprente kontratën e punës me datë ... për shkak të daljes në pension, mbushjes së moshës 65 vjeç.

Me Vërtetimin e asaj Shkolle është vërtetuar se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune si mësimdhënëse nga vitit 1975 ka përvojë pune mbi 40 vite dhe pagat neto për muajt korrik, gusht shtator 2016 ka qenë në shumë prej 450.20€, rrethanë kjo e vërtetuar nga deklarata e llogarisë së P.C.B. të datës ..., nga u vërtetua lartësia e kërkesëpadisë.

K. Gj. - D. A., paditëses së dytë Sh. B. e lindur me ... e punësuar në punët dhe detyrat e punës si profesoreshë në Gjimnazin "H. D." Gjakovë, i ndërprente kontratën e punës me datë ... për shkak të daljes në pension dhe mbushjes së moshës 65 vjeç.

Nga Vërtetimet e asaj shkolle vërtetohet se paditësja ka 40 vite përvojë pune në atë shkollë.

Nga Deklarata e llogarisë e P.C.B. e datës ... vërtetohet se e njëjta ka realizuar pagat për tre muajt e fundit para pensionimit për muajt gusht, shtator dhe tetor 2016 shumën 525.87€ (paga neto) nga u vërtetua lartësia e kërkesëpadisë.

K. Gj. - D. A., paditësit të tretë R. H. i lindur me ... i punësuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SHFMU "J. S." M. i ndërprente kontratën e punës me datë ... për shkak të daljes në pension, mbushjes së moshës 65 vjeç.

Nga vërtetimet e asaj Shkolle vërtetohet se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune nga data ... e deri me ... dhe ka mbi 42 vite përvojë pune.

Nga Historiati i llogarisë së P.C.B. të datës ..., për paditësin R. lidhur me ekzekutimin e pagave për maj, qershor dhe korrik 2016 kanë qenë në shumë prej 472.19€ nga u vërtetua shuma e lartësisë së kërkuar.

K. Gj. - D. A., paditësit të katërt K. O. i lindur me ... i punësuar në punët dhe detyrat e punës si sekretar në SFMU "M. K." Gjakovë i ndërprente kontratën e punës me datë ... për shkak të daljes në pension, mbushjes së moshës 65 vjeç.

Nga Vërtetimin e asaj Shkolle vërtetohet se paditësit ka qenë në marrëdhënie pune nga data 1 shtator 1974 në punë dhe detyra të punës të ndryshme deri me datën ..., ndërkaq nga data ... e deri me ... ka qenë në cilësinë zyrtarit administrativ në atë shkollë dhe ka mbi 30 vite përvojë pune .

Nga Historiati i llogarisë së R. b. datë ... , për paditësin K. lidhur me ekzekutimin e pagave për maj, qershor, korrik 2016 kanë qenë në shumë prej 462.00€, nga u vërtetua shuma e pagave të kërkuara.

K. Gj. - D. A., paditëses S. R. data e lindjes ... e punësuar në punët dhe detyrat e punës si profesoresh në SH.M.T " N. N." i ndërpre në kontratën e punës me datë ... për shkak të daljes në pension dhe mbushjes së moshës 65 vjeç.

Me Vërtetimin e asaj Shkolle vërtetohet se paditësja S. ka qenë e punësuar në atë shkollë nga data ... deri me ... ka mbi 40 vite përvojë pune.

Nga Historiati i llogarisë së B. E. datë ... lidhur me ekzekutimin e pagave për muajt gusht , shtator, tetor 2016 vërtetohet se pagat neto kanë qenë në shumë prej 504.19 € nga u vërtetua lartësia e kërkesë padisë.

K. Gj. - D. A., paditëses së gjashtë S. H. data e lindjes ... e punësuar në punët dhe detyrat e punës si arsimtare në SHFMU "Z. R." Gjakovë , i ndërpre në kontratën e punës me datë ... për shkak të daljes në pension dhe mbushjes së moshës 65 vjeç.

Me Vërtetimin e asaj Shkolle vërtetohet se paditësja S. ka qenë e punësuar nga data ... në Q.A. "H. Z." Gjakovë e pastaj në SHFMU "Z. R." Gjakovë deri në pensionim me datë ... dhe ka mbi 40 vite përvojë pune. Paga mujore neto për muajt shkurt, mars, prill 2016 ka qenë në shumë prej 488,59 €.

Nga Qarkullimi për llogarinë, R. B. të datës ... lidhur me ekzekutimin e pagave për muajt shkurt, mars prill 2016 kanë qenë në shumë prej 488,59€ nga u vërtetua lartësia e kërkesë padisë.

K. Gj. - D. A., paditësit të shtatë E. H. data e lindjes ... , i punësuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënës në SHFMU " 8 D." K. i ndërpre në kontratën e punës me datë ... për shkak të daljes në pension dhe mbushjes së moshës 65 vjeç.

Nga Vërtetimi i asaj shkolle vërtetohet se paditësi E. ka qenë në marrëdhënie punë nga ... deri në pensionim dhe ka mbi 43 vite përvojë pune.

Nga Deklarata e llogarisë së P.C.B. të datës ... lidhur me ekzekutimin e pagave për muajt qershor, korrik ,gusht 2016 pagat kanë qenë në shumë prej 475.62€ nga u vërtetua lartësia e kërkesë padisë.

K. Gj. - D. A., paditëses së tetë Z. M. data e lindjes ... e punësuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SHFMU "A. Q." D. i ndërpre në kontratën e punës me datë ... për shkak të daljes në pension dhe mbushjes së moshës 65 vjeç.

Nga Vërtetimi i asaj shkolle vërtetohet se paditësja Z. qenë në marrëdhënie punë në atë shkollë nga ... e deri në pensionim dhe ka mbi 30 vite përvojë pune.

Nga Qarkullimi për llogarinë e N. B. të datës ... lidhur me ekzekutimin e pagave për muajt korrik ,gusht , shtator 2016 pagat kanë qenë në shumë prej 475.62€ nga u vërtetua lartësia e kërkesë padisë.

Sipas Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar që ka hyrë në fuqi me datë 11 prill 2014 e lidhur në mes të Kryetarit të SBASHK- ut dhe Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), e cila Kontratë për implikimet financiare sipas nenit 51 , dispozitat e kësaj Kontrate kanë filluar të zbatohet nga data 01 janar 2015 që ka efekt juridik në këtë çështje lëndore.

Sipas nenit 36 pika 9 të Kontratës punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar në vlerë;

- 9.1 për 10 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë,
- 9.2 për 20 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të dy pagave bazë,
- 9.3 për 30 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave bazë,
- 9.4 punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilar,
- 9.5 shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji pas plotësimit të kushteve.

10. punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi prej tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit.

Bazuar në këto dispozita ligjore dhe faktin që të gjithë paditësit kanë mbi 30 vite përvojë pune ju takojnë shpërblimi jubilar për 30 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave bazë dhe pagat përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit nga u vërtetua baza e kërkesëpadisë.

Gjykata vlerësoj pretendimet e palës së paditur mirëpo të njëjtat janë të pa qëndrueshme për faktin se paditësit janë pensionuar gjatë vitit 2016. Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës është lidhur me 11 prill 2014 e cila është e aplikueshme në këtë çështje lëndore. Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar e lidhur në mes të Ministrisë së Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës ka hyrë në fuqi me datë 11 prill 2014 e që sa i përket implikimeve financiare ka filluar të zbatohet nga data 01 janar 2015 dhe nuk ka të bëjë me çështjen e shfuqizuar me nenin 48 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18 prill 2017 . Sa i përket planifikimit të buxhetit për pagat e tilla, paditësit nuk mund të pësojnë lidhur me planifikimin e buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e kësaj Kontrate nga e organeve shtetërore. Andaj, pretendimet e tilla ishin pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes, nga se nuk kishin mbështetje ligjore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr bazuar në nenin 452.1 të LPK- së, ku pala e paditur ka detyrim në pagesën e shpenzimeve gjyqësore për taksë gjyqësore në shumat e cekura si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

C.nr. 692/ 18 , datë 27 dhjetor 2018

Gj y q t a r j a,
Afijete Sada Glllogjani

UDHËZIM JURIDIK; Kundër këtij Aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së tij Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.